

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7170
E hënë, 23 prill 2024
Çmimi 0.50 €

Pse ndodhi bojkoti!?

FACE 6

Shkruan:
Ismet KRYEZIU



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJYSMË MILIONI QYTETARË JANË REGJISTRUAR NË DY JAVËT E PARA

FACE 4-5



Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka shpalosur të hënën të dhëna të reja sa i përket procesit të regjistrimit të popullsisë. Kryeshfeti i ASK-së, Avni Kastrati, në një konferencë për medie në

Prishtinë, ka thënë se që nga 5 prilli e deri më tani 530 mijë persona janë regjistruar. Sipas tij, procesi është duke shkuar ashtu siç është planifikuar dhe pa sfida madhore. Ndërkaq Liza Gashi,

zëvendësiministër e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, ka bërë me dije se në kuadër të këtij procesi deri më tani 180 mijë qytetarë nga diaspora janë regjistruar

BE-ja ZYRTARISHT KUSHTËZON INTEGRIMIN E SERBISË ME NORMALIZIMIN E RAPORTEVE ME KOSOVËN

F.3



KOSOVA I KËRKON BE-së HEQJEN E MASAVE 'TË PADREJTA'

F.3

RENOVA

PUTZ
Mopedat
Xingyink - Telojë
Gurte-Verteaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 302 / +389 44 487 009
+389 44 487 705
Fax: +389 44 487 200
Mbr: +389 44 501 289



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princessa-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYRKOL - BUNJAKOL - CUROFASADË



Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
028 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 0039 246 301 Fax: +381 0039 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



INFINITY Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



VENDET EVROPIANE NGURROJNË T'I JAPIN UKRAINËS KUNDËRJARORË "PATRIOTË"

F.2

KOM-I KËRKON NGA QEVERIA KRIJIMIN E MASËS SË PËRKOHSHME PËR FUNKSIONALIZIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE

F.7

KURTI U MIRËPRIT NË SOFJE NGA KRYEMINISTRI NË DETYRË I BULLGARISË

F.5

EKONOMI



ALIU DHE RAMA NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM PËR TRI PROJEKTE NË VLERË 1.5 MILION EURO

F.8

KEDS-I FILLOI INSTALIMIN E SUPERPËRCUESIT QË DO TA ZGJIDHË PROBLEMIN E FURNIZIMIT ME RRYMË TË MALISHEVËS

F.8

SPORT



5 FITORE PËR 7 MUAJ, MERSIM ZEQIRI SYNON T'I FITOJË DY TITUL NË FSHATIN E TIJ GARANË

F.12

Vendet evropiane ngurrojnë t'i japin Ukrainës kundërajorë "Patriotë"

BRUKSEL, 22 PRILL - Duket se vendet evropiane, të cilat zotërojnë kundërajorë "Patriotë", po ngurrojnë t'i japin Ukrainës ndonjë prej tyre. Ukraina ka shumë nevojë për së paku shtatë "Patriotë" për t'i frenuar sulmet ajrore ruse.

Forca ajrore e Rusisë është shumë më e fuqishme se ajo e Ukrainës, por kundërajorët e sofistikuar të aleatëve perëndimorë të Kievit mund të përbëjnë kërcënim të madh për avionacion rus, teksa forcat e Krenliniut po çajnë përpara ngadalë përgjatë vijës së frontit 1 000 kilometra të gjatë.

Ministria e Jashtme e Holandës, Hanke Bruins Slot, tha se vendi i saj "po e shqyrton çdo mundësi tani për tani" dhe se po i ofron mbështetje financiare një nismë gjermane për ta ndihmuar Ukrainën të përfundojë mbrojtjen ajrore dhe të bëjë më shumë dronë. E pyetur gjatë një takimi të ministrave të Jashtëm dhe të

Mbrojtjes të Bashkimit Evropian pse Holanda po ngurron t'ia japë Ukrainës disa "Patriotë", Slot tha: "Ne po shqyrtojmë përsëri nëse mund të japim nga rezervat tona, por do të jetë e vështirë".

Javën e kaluar, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se aleanca ushtarake "i ka hartuar armët tona në dispozicion nëpër aleancë dhe ka kundërajorë të cilët mund t'i dhurohen Ukrainës".

Ai nuk tregoi se cilat vende zotërojnë kundërajorë "Patriotë". "Patriotët" janë kundërajorë raketorë të cilët mund t'i godasin avionët luftarakë, raketat lundruese dhe raketat balistike me reze të shkurtra veprimi.

Përparsi e rëndësishme e këtyre kundërajorëve të prodhuar nga SHBA-ja, përveç efikasitetit të tyre, është edhe fakti se trupat ukrainase janë të shtërtitura se si t'i përdorin ata.

Nevojitet kohë e gjatë për të



prodhuar "Patriotë" - hiç më pakse dy vjet, sipas disa parashikimeve, prandaj vendet po ngurrojnë t'i japin ata dhe ta ekspozojnë veten. Gjermania i ka 12 të tillë, por po ia jep tre Ukrainës.

Polonia, e cila është në kufi me

Ukrainën, i ka dy kundërajorë "Patriotë" dhe i duhen për ta mbrojtur veten.

I pyetur nëse vendi i tij do të ofrojë ndonjë, ministri i Mbrojtjes i Suedisë, Pal Jonson, tha: "Nuk e përjashtoj këtë mundësi, por tani

për tani jemi të përqendruar të kontribuojmë financiarisht."

Ndërkohë, ministri i Jashtëm i Spanjës, Jose Manuel Albares, tha se vendi i tij do ta marrë "vendimin në përputhje me pushtetin që e ka për ta mbështetur Ukrainën".

Jep dorëheqje shefi i inteligjencës i ushtrisë izraelite

JERUSALEM, 22 PRILL - Shefi i inteligjencës i ushtrisë së Izraelit, Aharon Haliva, ka dhënë dorëheqje të hënën për shkak të dështimit për ta parandaluar sulmin e 7 tetorit nga Hamas, grup i shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, ka njoftuar ushtria izraelite.

Ai është figura e parë e lartë që jep dorëheqje prej se Izraeli u përbalë me sulmin më vdekjeprurës në historinë e vet.

Dorëheqja e gjeneralmajor Halivës mund ta hapë rrugën për dorëheqje të tjera në mesin e shefave të lartë të sigurisë në Izrael në lidhje me sulmin e Hamasit, kur militantët e këtij grupi i thyen muret mbrojtëse të Izraelit dhe të



pasfiduar për orë të tëra kaluan nëpër komunitete izraelite duke i vrarë 1 200 njerëz, kryesisht civilë, derisa i rëmbyen edhe 250 të tjerë për t'i dërguar brenda Gazës.

Ai sulm e ndezi luftën kundër Hamasit në Gazë, e cila është në muajin e shtatë tani. "Drejtoria

inteligjencës në udhëheqjen time nuk i përbushi detyrat që na u besuan. Ajo dihte e zezë nuk më hiqet nga mendja, as ditën e as natën. Gjithmonë do të vuaj nga kjo dhimbje e tmerrshme e luftës", ka shkruar Haliva në letërën e dorëheqjes.

Haliva, si dhe liderë të tjerë ushtarakë dhe të sigurisë, pritej se do të jepnin dorëheqje si përgjigje për dështimet e mëdha për ta parandaluar sulmin e 7 tetorit.

Megjithatë, se kur do të jepnin ata dorëheqje ka qenë e paqartë për shkak se Izraeli është ende duke luftuar kundër Hamasit në Gazë dhe kundër grupit militant libanez Hezbollah në kufirin verior.

Tensionet në mes të Izraelit dhe Iranit janë gjithashtu të larta pas sulmeve të ndërsjella. Disa ekspertë ushtarakë kanë thënë se dorëheqja në një kohë kur Izraeli është i angazhuar në shumë fronte është papërgjegjësi dhe mund të çliësohet si shenjë dobësie. Pak pas sulmit, Haliva kishte thënë publikisht se e bart barrën e

përgjegjësisë për dështimin e parandalimit të sulmit si shef i departamentit ushtarak, përgjegjësia e të cilit është t'i japë qeverisë dhe ushtrisë informata parajlmëruese dhe paralajmërueme ditore.

Si pasojë e luftës së Izraelit të nxitur nga ai sulm, më shumë se 34 000 palestinezë janë vrarë në Gazë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë. Kjo ministri nuk bën dallimin mes civilëve dhe luftëtarëve të vrarë, por ka thënë se dy e treta e viktimave ishin gra dhe fëmijë. Luftimet kanë detyruar mbi 80 për qind të popullsisë së Gazës të zhvendoset dhe qindra mijëra janë buzë urisë absolute, kanë thënë Kombet e Bashkuara dhe agjencitë ndërkombëtare të ndihmës.

Koreja e Veriut e teston një raketë balistike, thotë Koreja e Jugut

PENJAN, 22 PRILL - Koreja e Veriut e ka shprehur një raketë balistike në drejtim të ujërave të vet lindorë të hënën, sipas ushtrisë së Koresë së Jugut.

Ky është testimi më i fundit në një varg testimesh të armëve nga Koreja e Veriut.

Shtabi i Përgjithshëm i Koresë së Jugut tha se testimi ndodhi të hënën, por nuk dha hollësi të tjera si, për shembull, sa larg futuroi raketa. Koreja e Veriut është duke e vazhduar testimin e armëve me

ritëm të lartë, sepse dëshiron ta forcojë dhe zgjerojë ushtrinë në një kohë mosmarrëveshjes diplomatike me Shtetet e Bashkuara dhe Korenë e Jugut. Koreja e Veriut njoftoi të shtunën se e ka testuar një kokë raketore të një raketë lundruese "tejet të madhe" dhe një raketë të re kundërajrore në pjesën e bregdetit perëndimor të premtën.

Disa ekspertë kanë thënë në herët se Koreja e Veriut mund të bëjë provokime të mëdha, si

lëshimin e një sateliti të ndaluar këtë muaj për të shënur përvjetorë të rëndësishëm shtetërorë - ditëlindjen e themeluesit të shtetit Kim Il Sung më 15 prill dhe përvjetorin e themelimit të ushtrisë së Veriut më 25 prill.

Ushtria e Koresë së Jugut tha të hënën se ka gjetur dëshmi se Koreja e Veriut është duke u përgatitur ta lëshojë satelitin e dytë spion, por nuk ka shenja se lëshimi i një sateliti të tillë është i pashmangshëm.



Kosova i kërkon BE-së heqjen e masave "të padrejta"

EPOKA
E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 PRILL - Qeveria e Kosovës ka lëshuar të hënën një deklaratë për medie në lidhje me procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit, sipas udhëzimit administrativ, mbështetur në nenin 72 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Qeveria e Kosovës ka shprehur keqardhje për pjesëmarrjen e ulët në votimin e së dielës dhe ka falënderuar ata të cilët ushtruan të drejtën e tyre demokratike dhe ligjore.

Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) njoftoi të dielën se ka dështuar nisim për shkarkimin e kryetarëve në Leposaviq, Zveçan, Mitrovicë të Veriut dhe Zubin Potok, pasi vetëm 253 persona votuan prej 46.556 qytetarëve që kishin të drejtë vote.

Për të qenë i suksesshëm procesi, do të duhej të votonin 50 për qind plus 1 votes. Kjo nënkupton se kryetarët aktualë do t'i vazhdojnë mandatet e tyre. "Jemi të vetëdijshëm ndaj rrethanave në katër komunat në veri të Kosovës, sidomos trysinë së madhe të ushtruar nga autoritetet e Beogradit ndaj qytetarëve serbë të Kosovës në këto komuna. Rezultatet e votimit të 21 prillit tregojnë që nuk ka vullnet për t'i

shkarkuar kryetarët aktualë. Rikujtojmë se ky proces ishte nxitur nga kërkesa e vazhdueshme për zgjedhje të reja në këto komuna, duke marrë shkas mungesën e legjitimitetit të plotë të kryetarëve aktualë pas daljes së ulët të qytetarëve në zgjedhjet e 23 prillit 2023. Ai filloi me grumbullimin e nënshkrimeve të 20 % të nevojshëm të qytetarëve me të drejtë vote. Megjithatë, Lista Serbe që fillimisht ishte shqaktare e zgjedhjeve të 23 prillit përmes dorëheqjes së kryetarëve të saj, e pastaj inicieuse e votimit të 21 prillit, përsëri bojkotoi procese demokratike, përkundër thirrjeve të komunitetit ndërkombëtar dhe interesit qytetar", është thënë në deklaratën e qeverisë.

Me këtë rast, Qeveria e Republikës së Kosovës ka shprehur edhe një herë mbështetjen dhe gatishmërinë e saj për të bashkëpunuar me kryetarët e komunave të Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit për përmbyshjen e përgjegjësi të tyre dhe shërbimin ndaj qytetarëve të këtyre katër komunave, pa dallim. "Me përfundimin e këtij procesi, pa marrë parasysh rezultatit, Republika e Kosovës ka përmbyshur obligimin e saj ndaj qytetarëve të saj dhe përgjegjësinë e marrë nga dakordimi me Bashkimin



Evropian për deeskalimin e situatës në veri të vendit. Andaj, pas votimit të së dielës, është koha që masat e padrejta ndaj Kosovës përfundimisht të largohen", është theksuar në deklaratën e Qeverisë së Kosovës. Nisma për largim ose jo të kryetarëve u organizua pasi bashkësia ndërkombëtare kërkoi largimin e kryetarëve shqiptarë

nga pozitat e tyre, duke theksuar se, ndonëse procesi i prillit të vitit të kaluar - kur ata i kanë fituar zgjedhjet - ishte i ligjshëm, megjithatë, ai nuk e pasqyroi vullnetin e qytetarëve. Zgjedhjet e prillit të vitit 2023 ishin organizuar pas dorëheqjeve të serbëve nga institucionet e Kosovës. Edhe në ato zgjedhje Lista Serbe,

partia kryesore e serbëve në Kosovë, e kishte bojkotuar procesin zgjedhor dhe u kishte bërë thirrje serbëve lokalë të veprojnë njëjtë.

Blloku evropian ka shprehur keqardhje për vendimin e Listës Serbe që të mos marrë pjesë në votimet 21 prillit, ani pse paraprakisht ishte deklaruar pozitivisht për to.

BE-ja zyrtarisht kushtëzon integrimin e Serbisë me normalizimin e raporteve me Kosovën

PRISHTINË, 22 PRILL - Këshilli i Ministrave i Bashkimit Evropian (BE) e ka miratuar sot vendimin përfundimtar për ta ndryshuar kornizën negociuese për anëtarësim me Serbinë, duke e kushtëzuar pranimin e saj me normalizimin e marrëdhënieve me fqinjën e vet, Kosovën.

Ky ndryshim ka të bëjë me kapitullin 35 të kornizës negociuese, në të cilin zbatimi i Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën tani bëhet edhe kusht formal për Serbinë në procesin e negociatave të anëtarësimit në bllok.

Në tekstin e ri të kornizës negociuese si kusht është vendosur kjo fjali: "Serbia zbaton plotësisht obligimet që dalin nga Marrëveshja në rrugën drejt normalizimit të raporteve mes Kosovës dhe Serbisë, sipas Aneksit të zbatimit të saj, siç ishin pajtuar më 18 mars të vitit 2023".

Më 27 shkurt 2023 në Bruksel, Kosova dhe Serbia kishin arritur Marrëveshjen Bazë, ndërkaq më 18 mars në Ohër u arrit pajtimi për Aneksin e zbatimit të marrëveshjes.

Komisioni Evropian dhe Shërbimi i Veprimit të Jashtëm të BE-së (EEAS), të cilat edhe kishin propozuar këto ndryshime, e kanë

mirëpritur vendimin e Këshillit të Ministrave për ta miratuar ato, sipas zëdhënësit të BE-së, Peter Stano. "Të dyja palët kishin pranuar obligimet e tyre përkatëse, se Marrëveshja për normalizimin (e marrëdhënieve) do të bëhej pjesë përbërëse e rugëtimit të tyre të integritimeve evropiane. Zbatimi i Aneksit të arritur në mars të vitit 2023 reflekton këtë obligim të të dyja palëve", tha Stano.

Stano konfirmoi se edhe për Kosovën do të bëhet formal një detyrim i tillë përmes një grupi "special për normalizim". "Agjenda e takimit të ardhshëm të grupit special për normalizim për Kosovën do të përditësohet, po ashtu. Ne presim që të dyja palët ta zbatojnë Marrëveshjen dhe të gjitha obligimet e tjera që kanë mbetur nga dialogu, sepse kjo është kyçe për rrugëtimitin e tyre përkatës evropian", shtoi ai.

Pajtimin për këto ndryshime e kishin arritur ambasadorët e vendeve anëtare të BE-së javën e kaluar.

Ky ndryshim ishte kërkuar për ta përfshirë edhe obligimin për zbatimin e marrëveshjes nga dialogu i Serbisë me Kosovën si kusht në kuadër të kapitullit 35 të negociatave të anëtarësimit qysh kur ishte arritur marrëveshja para



një viti. Përparimi në procesin e normalizimit të raporteve me Kosovën edhe më herët kishte qenë pjesë e kushtëzimeve në negociatat e anëtarësimit të Beogradit në BE, por tani në mënyrë specifike përmendet kushti i zbatimit të marrëveshjes të arritur vitin e kaluar.

Kjo marrëveshje, prej 11 nënesh, ndër të tjera, parashihet edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

BE-ja insiston se marrëveshja dhe aneksi, pavarësisht se nuk janë nënshkruar nga palët, janë obligime ligjore për të dyja vendet. Serbia përmes zyrtarëve të saj disa herë ka thënë se ajo nuk do të zbatojë pjesë të marrëveshjes që kanë të bëjnë me integritetin territorial dhe pranimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.



Gjysmë milioni qytetarë janë regjistruar në dy javët e para

Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka shpallur të hënën të dhëna të reja sa i përket procesit të regjistrimit të popullsisë. Kryeshafi i ASK-së, Avni Kastrati, në një konferencë për medie në Prishtinë, ka thënë se që nga 5 prilli e deri më tani 530 mijë persona janë regjistruar. Sipas tij, procesi është duke shkuar ashtu siç është planifikuar dhe pa sfida madhore. Ndërkaq Liza Gashi, zëvendësministre e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, ka bërë me dije se në kuadër të këtij procesi deri më tani 180 mijë qytetarë nga diaspora janë regjistruar

veri: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan, të banuara me shumicë serbe, ndërsa serbët nga komunat e tjera në jug, me ftesë të Beogradit, kryesisht e kishin bojkotuar procesin. Sipas Kastratit, deri më tani katër apo pesë ekonomi familjare kanë refuzuar të regjistrohen. "Jemi duke vazhduar procedurat ligjore, dhe të gjithë ata që refuzojnë, do të përcillen sipas ligjeve në fuqi", ka theksuar ai.

Sipas Ligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, çdo person mund të gjohet nga 30 deri në 2 000 euro nëse refuzon t'i japë informacionet e kërkuara nga regjistruesi.

Gjobat janë edhe më të mëdha, deri në 20 000 euro, për biznes. Liza Gashi, zëvendësministre e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD), shpallosi të dhënat për regjistrimin e diasporës. "Deri më tani kemi 180 000 mijë pjesëtarë të diasporës që janë regjistruar në kuadër të procesit, mbi 50 mijë janë regjistruar në platformën E-diaspora, prandaj u bëj thirrje bashkatdhetarëve të regjistruohen", është shprehur ajo. Sipas të dhënave zyrtare nga regjistrimi i kulturit e popullsisë, numri i përgjithshëm i banorëve në Kosovë është rreth 1.8 milion, prej të cilëve rreth 25 000 janë serbë.

Megjithatë, sipas vlerësimeve të organizatave joqeveritare serbe në Kosovë, në Kosovë jetojnë rreth 100 000 pjesëtarë të komunitetit serb.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë ka nisur nga data 5 prill dhe do të vazhdojë deri më 17 maj.

Regjistrimi i ri i popullsisë ishte menduar të mbahej në vitin 2021, por ai u shty për shkak të pandemisë së virusit korona. Ndërsa vitin e kaluar është shtyrë edhe dy herë të tjera.

Kurti u bënë thirrje komuniteteve joshumicë të marrin pjesë në regjistrimin e popullsisë

Ndërkaq kryeministri Albin Kurti në një video mesazh në "Facebook" u është adresuar me një mesazh komuniteteve joshumicë, serb, boshnjak, turk, ashkali, egjiptian, rom dhe goran në lidhje me regjistrimin e popullsisë, duke theksuar se regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është një ndër ndërmarrjet më të rëndësishme për shtetin tonë. "Ai nuk është thjesht një shënim statistikor: është deklaratë e fuqishme e identitetit, të drejtave, dhe vendit të secilit qytetar në shoqërinë tonë. Nuk është thjesht një ushtrim burokratik; është

mekanizëm përmes të cilit ne formojmë politika dhe ndajmë burime për të siguruar që çdo qytetar, pa marrë parasysh etninë apo besimin, do të marrë mbështetjen dhe shërbimet që i takojnë. Andaj, mos ngurroni, regjistrohuni!", ka thënë Kurti, duke shtuar se në bazë të tij bëhet ndarja dhe shpërndarja e buxhetit të shtetit. "Rezultatet e tij përcaktojnë politikat sociale dhe zhvillimore të shtetit, investimet në komunitetet tuaja, subvencionet në mbështetje tuaj, programet e shërbimit sociale dhe shëndetësore. Vetëm me një regjistrim të plotë e të saktë do të mund ta dimë më së miri se për sa çerdhe e shkolla keni nevojë; se sa hapësira kulturore, rekreative e sportive duhet të planifikohen në shërbim të komuniteteve tuaja; çfarë programe e politika sociale i përgjigjen nevojave tuaja e kështu me radhë", ka pohuar ai.

Kryeministri ka theksuar se regjistrimi është dokumentim zyrtar i përbërjes së shoqërisë sonë. "Të dhënat e tij pastaj bëhen pasqyrë e politikave tona dhe përgjigjësi e shtetit dhe institucioneve tona. Regjistruesit do të vijnë derë më derë. Mirëprirni ata si mikpritës të mirë që jeni. Komunitetet joshumicë janë vlerë e identitetit i shtetit tonë. Shoqëria jonë është e pasur sepse ju jeni pjesë e saj. Andaj, mos ngurroni, regjistrohuni!", është thënë në mesazhin e Kurtit.

EPOKA
5 APRIL **Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 22 PRILL – Mbi gjysmë milionit qytetarë rezidentë dhe rreth 36 për qind e të gjitha objekteve janë regjistruar në dy javët e para të procesit të regjistrimit të popullsisë në Kosovë, njoftoi Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) të hënën.

Kryeshafi ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, në një konferencë për medie në Prishtinë, ka thënë se procesi është duke shkuar ashtu siç është planifikuar dhe pa sfida madhore. "Deri më tani [21 prill] janë regjistruar 530 000 persona si dhe mbi 36 për qind e objekteve në Kosovë. Po flasim për popullsinë rezidente në Kosovë. Stafit është stabilizuar këto ditë, ka filluar intervistat në mënyrë masive", ka pohuar ai.

Kastrati ka theksuar, po ashtu, se ky proces është duke u zhvilluar

Pse ndodhi bojkoti!?



Shkruan: Ismet KRYEZIU

Mund të ketë një milion e njëqind arsye politike e strategjike? Por arsyen kryesore 50 % + 1 votë e dimë të gjithë. Pra arsyeja themelore të cilën e dimë të gjithë ose më e përafërta, është standardi 50 % + 1 e votuesve nga lista përfundimtare e votuesve,

duhet të votojnë PRO largimit të kryetarit. Ky standard automatikisht e bën të domosdoshëm dhe pjesëmarrjen mbi 50 % të votuesve në zgjedhje, për të arritur legjitimitet dhe për tu konsideruar proces i suksesshëm.

A është standard demokratik, PO është. A është standard i pa arritshëm, PO është.

Ky standard nuk do të arrihej jo vetëm në komunat e veriut, por me pikëpyetje të madhe mund të arrihet në cilën do Komunë të Kosovës.

Qytetarët e këtyre komunave, duke e parë se ishin futur me një proces që mund të dilnin humbës

dhe të legjitimomin kryetarët e komunave që erdhën me nga 100 vota kryetar, vendosen të shmangin këtë legjitimitet të kryetarëve aktual përmes pjesëmarrjes së tyre në votim. Edhe e bojkotuan procesin e votimit. Lista përfundimtare e votuesve në Kosovë jo vetëm ajo ne veri, për nga saktësia është shumë e diskutueshme dhe jo reale, përfshi sfidat dhe numrin e votuesve jo rezident në Kosovë, me të drejtë vote. Kush do të vinte në Kosovë nga një shtet tjetër për të votuar, për një kryetar komune ose për të shkarkuar një kryetar komune. E shumta ndonjë qytetar i rrallë ose askush!?


Rëndësia e pjesëmarrjes në votim është thelbësore për demokracinë, por nuk duhet të harrojmë asnjëherë se dhe bojkoti është veprim politik dhe demokratik. Bojkoti i procesit të votimit zakonisht ndodhë si protestë politike, si instrument rezistence, si refuzimi i legjitimitetit të institucioneve dhe politikave të cilat mund të cenojnë të drejtat e një komuniteti dhe sjahnë mjaftueshëm përfaqësuese për interesat e tyre.

Prandaj, qytetarët serb dhe vendosën të refuzojnë dhe të bojkotojnë procesin e votimit, vendosen që të protestojnë politikisht kundër pjesëmarrjes në

një proces që do të legjitimonte kryetarët aktual.

Institucionet dhe qeveria e Kosovës, janë përgjegjëse që të ndërmarrin veprime politike e institucionale të minimizojnë arsyet e protestës politike të komunitetit serb dhe të ofrojnë si alternativë të vetme, integrimin edhe përfaqësimin e tyre në institucione. Nuk mund të pretendosh se po i shërben një ambientit integruar e demokratik, duke injoruar protestën politike dhe duke e promovuar si të arritur demokratike, qeverisjen e një komuniteti shumicë me kryetar të një komuniteti pakicë e të zgjedhur me nga 100 vota.

Kurti u mirëprit në Sofje nga kryeministri në detyrë i Bullgarisë



SOFJE, 22 PRILL - Kryeministri Albin Kurti u mirëprit të hënën nga kryeministri në detyrë i Bullgarisë, Dimitar Glavchev.

Miqësia dhe partneriteti ndërmjet Kosovës dhe Bullgarisë, marrëdhëniet e mira ekonomike dhe vullneti i dyanshëm për zgjerimin e tyre, ishin temat qëndore të bisedës dhe takimit.

Bullgaria njohu pavarësinë e Kosovës në mars të vitit 2008, ndërkaq sivjet shënojmë 15-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike. Deri më tani kemi të nënshkuara tetë marrëveshje dypalëshe dhe disa të tjera që presin të finalizohen. Me synim fuqizimin e raporteve ekonomike dhe shkëmbimeve tregtare, në qershor të vitit të

kaluar u themelua Oda Ekonomike Kosovë - Bullgari me seli qendrore në Sofje. Këtë vit planifikohet të organizohet forum i përbashkët i bizneseve të Kosovës dhe Bullgarisë. Bullgaria kishte luajtur një rol të rëndësishëm për ne në vitin 1999 duke hapur hapësirën e saj ajrore për aeroplanët e NATO-s në fushatën kundër Serbisë, që i

dha fund gjenocidit ndaj shqiptarëve në Kosovë. Ajo vazhdon të japë kontribut të rëndësishëm në sigurinë e vendit tonë me pjesëmarrjen dhe praninë e trupave të saj në Kosovë në kuadër të misionit të KFOR-it.

Gjatë takimit, kryeministri Kurti dhe kryeministri në detyrë i Bullgarisë, Glavchev, diskutuan edhe për situatën e sigurisë në

kontinentin e Evropës dhe atë në rajon, dhe folën për nevojën e bashkëpunimit sa më të thellë ndërmjet shteteve mike e partnere dhe ndërmjet shoqërive demokratike. Në vizitën e tij të parë në Bullgari, kryeministri Kurti u shpreh i nderuar me pritjen nga homologu tij dhe falënderues për mbështetjen e vazhdueshme të Bullgarisë.

Në 25-vjetorin e rënies u përkujtua dëshmori Brahim Morina

MALISHEVË, 22 PRILL - Në 25-vjetorin e rënies në altarin e lirisë, u përkujtua dëshmori i kombit, Brahim Morina, nga fshati Drenoc. Në përkujtim të rënies së tij u bënë homazhe dhe u vendosën lule në Varrezat e Dëshmorëve në Malishevë, ku edhe prehet trupi i dëshmorit. Homazhe dhe nderime në

përkujtim të dëshmorit Brahim Morina, bashkë me familjarë, kanë bërë edhe kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, nënkryetari Vesel Krasniqi, drejtor të drejtorive komunale, kryetari i Degës së OVL të UÇK-së në Malishevë, Metush Kryeziu, bashkëluftëtarë dhe qytetarë të shumtë. "Gjaku

dhe sakrifica e dëshmorit Brahim Morina dhe të gjithë dëshmorëve të kombit janë themeli i shtetndërtimit, prandaj ne të gjallët me respektin më të madh i kujtojmë dëshmorët dhe duhet të punojmë për ndërtimin e komunës sonë dhe të vendit në përgjithësi", ka thënë Kastrati.



Jepen 18 leje ndërtimore në Gjilan, tejkalohen të hyrat

GJILAN, 22 PRILL - Trendi i rritjes së vëllimit të punës, po ashtu edhe të të hyrave, ka vazhduar edhe në tre muajt e parë të këtij viti në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në komunën e Gjilanit. Në raport me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2023 është realizuar rritje në kuotën 126%. Ali Arifi, drejtor për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, tha se janë munduar të jenë sa më transparentë. Të gjitha kërkesat që i paraqesin palët e të cilët i plotësojnë kushtet trajtohen sipas afatit ligjor. Ai tregoi se nga 1 janari deri më 31 mars të këtij viti kanë pranuar për shqyrtim 194 kërkesa. Derisa kanë punuar 319 akte, shprehur në përqindje 164%. "Kemi pranuar 22 kërkesa për leje ndërtimore, derisa janë lëshuar 18 leje", ka

thënë Arifi. Ai ka theksuar se edhe këtë vit vazhdojnë me trend të rritjes permanente të të hyrave, ku në raport me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2023, kanë realizuar rritje në kuotën 126%. "Kemi realizuar të hyra në vlerë 300 mijë e 327 euro, apo 62 mijë e 595 euro më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2023 që ishin 237 mijë e 732 euro", ka thënë Arifi. Drejtori për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit ka thënë se në raport me planin e punës për 1 janari deri 31 mars (TM-1) të vitit 2024 kanë realizuar të hyra në kuotën 172%, derisa ishin të planifikuara 174 mijë e 730, që është për 125 mijë e 597 euro më shumë sesa janë planifikuar. Planifikimi i të hyrave për këtë vit është 860 mijë euro, ndërsa për 3 muajt e parë të vitit janë inkasuar 35 për qind.



Shoqata Ndërkomunale e të Verbërve kërkon mbështetje financiare nga Bulliqi

PODUJEVË, 22 PRILL - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka zhvilluar takim me Shoqatën Ndërkomunale të të Verbërve Prishtinë, me përfaqësues Behxhet Gashi dhe anëtarët e tjerë të shoqatës, me të cilët ka diskutuar për sfidat dhe aktivitetet e tyre. Shoqata Ndërkomunale e të Verbërve në Prishtinë është shoqatë rajonale e cila përfaqëson 6 komuna, me rreth 600 anëtarë, ku 100 janë nga komuna e Podujevës. Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e shoqatës kërkuar nga kryetari Bulliqi mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve të tyre të cilat realizohen nga anëtarët, si lojëra në shah, futbollit me zile, orientimi në



hapësirë e të tjera. Kryetari Bulliqi i njoftoi për thirrjen që do të hapet në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë për mbështetje të organizatave që

merren me personat me nevoja të veçanta, në kuadër të saj edhe do të shqyrtohet mundësia e ndihmës financiare për shoqatën.

Limaj shkon për ngushëllime në familjen e Gani Imerit

VUSHTRRI, 22 PRILL - Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, së bashku me bashkëpunëtorë, ka shkuar për ngushëllime në familjen Imeri, me rastin e ndarjes nga jeta të ish-komandantit të UÇK-së, Gani Imeri. "Sot me bashkëpunëtorë për të ndarë dhimbjen për vdekjen e

bashkëluftëtarit, Gani Imeri! Ganiu do të mbetet në kujtesën tonë si një humanist e një person i jashtëzakonshëm me vlera të mëdha njerëzore. Edhe një herë i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes, miqve dhe gjithë bashkëluftëtarëve të të ndjerit!", ka shkruar Limaj në rrjetet sociale.



300 pemë të reja në kryeqytet për Javën e Tokës

Prishtinë, 22 prill - 300 pemë të reja janë mbjellë të hënën në Prishtinë për Javën e Tokës. "Mbjelljet i filluam në parkun e

lagjes 'Dardania', ndërsa në parkun e lodrave në lagjen 'Ulpiana' nisën punimet për renovimin e tërësishtëm të

hapësirë rekreative për fëmijë. Gjatë javës do të vazhdojë gjelbërimi i lagjeve e rrugëve të ndryshme në kryeqytet, sepse

të gjelbër e duam të gjithë Prishtinën", ka bërë me dije kryetari i Prishtinës, Përparim Rama.



Hoxhaj propozon që Kuvendi ta miratojë rezolutën e OKB-së për përkujtimin e gjenocidit në Srebrenicë

PRISHTINË, 22 PRILL - Ish-ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka njoftuar se të hënën në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës ka propozuar që Kuvendi, në ditën kur Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara aprovon rezolutën për "Ditën Ndërkombëtare të Kujtimit dhe Përkujtimit të Gjenocidit të vitit 1995 në Srebrenicë", të njëjtën rezolutë ta mbështesë edhe Kuvendi i Kosovës. "Sot, në

Kryesi të Kuvendit të Kosovës, kam propozuar që Kuvendi në ditën kur Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara aprovon rezolutën për "Ditën Ndërkombëtare të Kujtimit dhe Përkujtimit të Gjenocidit të vitit 1995 në Srebrenicë", të njëjtën rezolutë ta mbështesë edhe Kuvendi i Kosovës. Duke mos qenë anëtare e OKB-së ku do të ishim përkrahës të natyreshëm të kësaj rezolute, kjo është mënyra më

mirë për Kosovën që t'i bashkohet botës demokratike në dënimin dhe përkujtimin e gjenocidit në Srebrenicë", ka shkruar Hoxhaj në "Facebook". Ai ka thënë se ballafaqimi me të kaluarën është më se i nevojshëm dhe politika gjenocidale dhe serbomadhe e Beogradit ndaj Kosovës, Bosnjës dhe Kroacisë, duhet të ndëshkohet dhe përkujtohet me qëllim që ajo kurrë të mos rikthehet në rajon.



KOMF-i kërkon nga qeveria krijimin e masës së përkohshme për funksionalizimin e shërbimeve sociale

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 PRILL - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF-i, i cili përfaqëson tridhjetë e katër organizata joqeveritare, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës krijimin e masës së përkohshme për funksionalizimin e shërbimeve sociale në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike si një masë tranzitore deri në rregullimin e financimit të qëndrueshëm për shërbime sociale.

Ministria e Drejtësisë, në mars 2024, në mbështetje të shërbimeve sociale, ka ndarë 1.5 milion euro për subvencionimin e shërbimeve të 40 organizatave joqeveritare të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale. Megjithatë, ky fond nuk është i mjaftueshëm për ta funksionalizuar ofrimin e shërbimeve sociale për fëmijët e cenushtëm, sikurse fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët viktimë të dhunës dhe abuzimit, fëmijët në punë të rënda, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët përdorues të drogave, fëmijët në konflikt me ligjin si dhe familjet e tyre. "Bëjmë me dije se ofruarit e shërbimeve sociale në vitin 2024 janë në gjendjen më të rëndësishme sa i përket financimit të shërbimeve sociale krahasuar me vitet e fundit, për arsye që në dhjetor 2023, për pjesën dërrmuese, kanë përfunduar programet dhe projektet e donatorëve ndërkombëtarë në mbështetje të shërbimeve sociale, duke lënë zbrazëturë të mëdha në financimin e shërbimeve sociale. Duke pasur parasysh që pjesa



dërrmuese e ofruesve nga sektori joqeveritar që ofrojnë shërbime sociale janë financiar në masën më të madhe nga donatorët ndërkombëtarë, të cilët prej disa muajsh kanë mbyllur programet, situata aktuale është në prag të kolapsit", është thënë në komunikatën e KOMF-it. Sipas të dhënave të organizatave anëtare të KOMF-it, mbështetja aktuale e marrë nga Ministria e Drejtësisë mesatarisht mbulon rreth 6% shërbimet rezidenciale dhe rreth 21% shërbimet sociale

ditore. "Në anën tjetër, përkundër decentralizimit të shërbimeve sociale, akoma nuk është rregulluar mekanizmi i financimit të qëndrueshëm të shërbimeve sociale. Për pasojë, komunat në përgjithësi nuk ndajnë buxhet për ofrimin e shërbimeve sociale, me përjashtim të disa përpjekjeve sporadike të bëra nga një numër shumë i vogël i komunave. Në këto rrethana, pavarësisht mbështetjes nga Ministria e Drejtësisë dhe vullnetit të ofruesve të shërbimeve sociale, është e pamundur për të

vazhduar ofrimin e shërbimeve me kapacitet të plotë për grupet më të cenuara të fëmijëve dhe familjet e tyre në Republikën e Kosovës", është theksuar në komunikatë. Sipas KOMF-it, kjo situatë mund të çojë në mbyllje të shërbimeve, apo reduktim masiv të përfituesve duke ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre. "Nisur nga kjo, KOMF ka kërkuar nga Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave që të rrisë mbështetjen në ofrimin e shërbimeve sociale për grupet e cenuara përmes

krijimit të një Mase të përkohshme për funksionalizimin e shërbimeve sociale, në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike. Mohimi për t'i siguruar fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, në mënyrë që fëmija të sigurojë mirëqenien, integrim dhe zhvillim sa më të plotë, përbën shkelje të parimeve bazë të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës", është theksuar në komunikatën e KOMF-it.

Të enjten Kuvendi mbledhet në seancë plenare

PRISHTINË, 22 PRILL - Nën drejtimin e kryetarit Glauk Konjufca, Kryesia e Kuvendit mbajti të hënën mbledhjen e radhës me kryetarë të grupeve parlamentare. Kryesia vendosi që Kuvendi të mbledhet në seancë plenare të enjten, më 25 prill, në orën 10:00, në të cilën do të shqyrtohen një varg projektligjesh që kanë të bëjnë kryesisht me ratifikimin e

marrëveshjeve ndërkombëtare, por edhe për çështje të tjera të parapara në rend dite. Në këtë mbledhje të Kryesisë, kryetari Glauk Konjufca përgëzoi delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për rolin proaktiv dhe kontributin në procesin e votimit të suksesshëm të aplikimit të Kosovës në Asambleen Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Kryesuesja e këtij delegacioni, njëherësh nënkryetare e Kuvendit, Saranda Bogujevci, vlerësoi lart rolin e secilit pjesëmarrës, duke konsideruar shumë të suksesshëm angazhimin dhe punën e përbashkët për gjatë gjithë këtij procesi. Në vijim Kryesia, konform kompetencave të veta, shqyrtoi edhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e Kuvendit.



Posta e Kosovës lanson pullat postare kushtuar mbrojtjes së ambientit

PRISHTINE, 22 PRILL - Posta e Kosovës ka lansuar pullat postare kushtuar mbrojtjes së ambientit. Sipas njoftimit, ky emision i pullave postare bartë mesazhet për rëndësinë e ambientit të

pastër, rrezikun e ndotjes nga qeset plastike dhe formën edukative të përdorimit të materialeve të reciklueshme. Mbrojtja e ambientit, në aspektin global, është pjesa më e rëndësishme e jetës në

planetin Tokë. Pjesë përbërëse e këtij emisioni është edhe Zarfi i Ditës së Parë, i cili do të qëndrojë në qarkullim postar deri në konsumimin e plotë. Posta e Kosovës, përmes

Filatelisë së saj, vazhdon përkrahjen e të gjitha iniciativave për të mirën e qytetarëve si dhe për promovimin e shtetit tonë nëpër botë, bëhet me dije në njoftimin e Postës së Kosovës.



KEDS-i filloi instalimin e superpërçuesit që do ta zgjidhë problemin e furnizimit me rrymë në Malishevë

MALISHEVË, 22 PRILL - KEDS-i të hënën ka filluar projektin e instalimit të "superpërçuesit" elektrik përmes së cilit pritet të zgjidhet problemi i furnizimit me energji elektrike për Malishevën dhe të gjitha fshatrat e kësaj komune deri në ndërtimin e nënstacionit nga ana e KOSTT-it, si një zgjidhje e qëndrueshme.

Për instalimin e këtij superpërçuesi, i pari i këtij lloji jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon, tashmë janë bërë të gjithë parametrat e paraparë dhe pritet të implementohet në linjën ekzistuese elektrike nga nënstacioni i Rahovecit në atë të Malishevës. Si i tillë, ky projekt është i një rëndësie të veçantë për rajonin e Malishevës, sepse mungesa e kufizuar e kapacitetit për furnizim nga infrastruktura aktuale deri më tash nuk i ka plotësuar kërkesat për konsumatorët tanë atje. Menaxhmenti i KEDS-it ka realizuar disa herë takime me autoritetet komunale të

Malishevës lidhur me këtë projekt kapital. Dhe meqë bëhet fjalë për rreth dy muaj punimesh në këtë linjë të gjatë mbi 15 kilometra, KEDS-i shfrytëzon rastin r'i informojë të gjithë konsumatorët e asaj ane se gjatë këtyre punimeve do të ketë ndërprerje të kohëpaskohshme të energjisë elektrike. Të gjitha informatat për këtë do të mund të gjenden të aktualizuara në faqen zyrtare të KEDS-it.

Me instalimin e këtij superpërçuesi pritet të mos ketë më sfida të furnizimit me rrymë për këta banorë. Krahas tij, KEDS-i ka në implementim e sipër në këtë komunë edhe 30 projekte të tjera të cilat do ta avancojnë rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, duke ofruar shërbime më kualitative dhe më të sigurua.

Vetëm përgjatë këtij viti KEDS-i pritet të realizojë 250 projekte të linjave të tensionit të ulët dhe atij të mesëm anembanë Kosovës, të cilat kapin një vlerë prej disa dhjetëra miliona eurosh.



Aliu dhe Rama nënshkruajnë memorandum për tri projekte në vlerë 1.5 milion euro



PRISHTINE, 22 PRILL - Komuna e Prishtinës dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturas (MMPHI) kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi në vlerë prej 1.5 milion eurosh për tri projekte. Ministri i MMPHI-së, Liburn Aliu, ka thënë se në ditët në vazhdim do të nënshkruajnë memorandumet edhe me komuna të tjera për projekte që janë në interes të qytetarëve e që ndërliken me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturas. "Sapo nënshkruam memorandumin e mirëkuptimit me komunën e Prishtinës për bashkëfinancimin e projekteve infrastruktururore. MMPHI po financon komunën me 1,500,000 euro. Qëllimi i këtij memorandumi

është bashkëfinancimi i projekteve infrastruktururore për projektet si më poshtë: Ndërlidhja e rrugës Kolovicë - Sofali; Vazhdimi i rrugës Bajram Bahtiri, rrugë kjo me 4 kors; si dhe kyçja në rrethin e Lakrishtës (ndërlidhja e Unazës së qytetit me rrugën Prishtinë - Fushë-Kosovë - Mitrovicë dhe rreth rotullimin e Lakrishtës). Gjithashtu, në ditët në vijim do të nënshkruajmë memorandumet me komuna të tjera për projekte që janë në interes të qytetarëve e që ndërliken me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturas", ka bërë me dije ministri Aliu. Ndërsa qytetari i Prishtinës, Përpam Rama, ka thënë se këto projekte do ta lehtësojnë jetën e qytetarëve tanë dhe janë zotime të cilat veçse po përmbushen.

Themelohet Task-Forca e Gjellbër

PRISHTINE, 22 PRILL - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturas, Liburn Aliu, ka bërë me dije të hënën se në krye me Inspektoratin e Mjedisit, në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës (MPB), Agjencinë e

Pyjeve (MBPZHR), Inspektoratin e Tregut (MINT), si dhe Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, kanë themeluar Task-Forcën e Gjellbër. Ai ka thënë në muajt në vazhdim do të jenë muajt të veprimeve konkrete për përmirësimin e

gjendjes së lumenjve, shkurtrimin e mbeturinave plastike, ndalimin e degradimit mjedisor brenda parqeve kombëtare dhe ndërmarrjen e veprimeve të tjera ad-hoc kundër degradimit mjedisor si pasojë e aktiviteteve ilegale.



Izraelitët, palestinezët dhe një aksident rrugor



Një mëngjes me shi në shkurt 2012, një autobus me fëmijë kopshë, me mësueset e tyre, u nisën nga Anata, një fshat palestinez në periferi të Jeruzalemit, drejt një sheshi lojrash në Ramallah. Më pak se njëzet minuta larg.

Është udhëtimi që studentët e Nour al Houda e presin prej muajsh: çanta shpine Superman, çokolata, lëng portokalli, uniforma shkollore dhe gjithë emocionet që shoqërojnë një ditë të tillë.

Në pak minuta, përgjatë rrugës Jaba, në veri të Jeruzalemit, një kamion bën një manovër të rrezikshme në asfaltin e lagur për të parakaluar autobusin e shkollës, duke e nxjerrë atë nga rruga.

Jemi në zonën C të Bregut Perëndimor, 60 për qind e territorit, ku jetojnë 300 mijë palestinezë. Por është Izrael, sipas marrëveshjeve të Oslos, që ka kontroll të plotë në çështjet civile dhe të sigurisë.

Rezultati është se automjetet palestineze të emergjencës nuk kanë lirinë për të lëvizur në mënyrë të pavarur, për të arritur në vendin e aksidentit. Ndërsa nga postblloku izraelit që ndodhet shumë pranë, askush nuk bën asgjë, duke pritur urdhrat. Kështu, në gjysmë ore në të cilën shpërthen zjarri si

pasojë e përplasjes, gjashtë fëmijë dhe një mësues do të vdesin sepse asnjë mjet palestinez, as palestinez dhe as izraelit, nuk vjen për t'i shpëtuar. Nga ky episod fillon "Një ditë në jetën e Abed Salama", libri në të cilin gazetari hebreo-amerikan Nathan Thrall gërmon brenda tragjedisë dhe rindërton me përpikëri atë që e shkaktoi, duke rrefyer jetën e atyre që humbën gjithçka ose dhanë gjithçka për të shpëtuar fëmijët, atyre që thyen rregullat dhe atyre që nuk ishin në gjendje ta bënin këtë. Dhe më pas e zgjeron vështrimin në të gjithë sistemin në të cilin ndodhi aksidenti, tek rregullat që bllokuan ekipet e shpëtimt, tek arsyet pse ajo rrugë ishte kaq e lënë pas dore dhe në përgjithësi tek ekzistenca shumë të ndryshme, vetëm disa qindra metra larg njëra nga tjetra, në të dy anët e murit që ka ndarë Izraelin dhe territoret palestineze, që nga viti 2002.

Libri, i botuar në Shtetet e Bashkuara më 3 tetor, ishte në qendër të një çështjeje editoriale, sepse disa nga prezantimet e planifikuara u anuluan: ishte shumë e vështirë të flitej në publik për një histori të treguar kryesisht nga pala palestineze, pas masakrës së Hamasit në Izraelin jugor më 7

tetor. Sot është futur në listën e vëllimeve më të mira të vitit 2023 nga Economist, New Yorker, Financial Times, Time Magazine dhe shumë gazeta të tjera.

Një botë larg

E takojmë Thrall-in, 44 vjeç, në qetësinë e një mëngjesi të shtunë në Jeruzalem, në sallat e YMCA-së, hotelit/hostelit historik të qytetit: pesëmbëdhjetë minuta vijë ajrore nga Anata, fshati në qendër të librit. Por, siç ndodh shpesh këtu, një botë larg. "Kjo është pikërisht ajo që doja të tregoja", shpjegon autori, i sapokthyer nga një turne promovues në Australi. "Kam jetuar në Jeruzalem për shumë vite dhe nga përvoja personale e di mirë se sa pak dinë izraelitët për palestinezët, dhe si jetojnë ata. Kjo e bën të pamundur çdo formë mirëkuptimi, ndjeshmërie: unë isha këtu në vitin 2012 kur ndodhi aksidenti. Më kujtohet shumë mirë që u bëmë edhe në mediat palestineze. Por për izraelitët, edhe pse masakra e fëmijëve kishte ndodhur në periferi të Jeruzalemit, shumë afër një postblloku me ushtarë izraelitë, në territorin e kontrolluar nga Izraeli, u dha si një lajm i shkurtër kronike".

Abedini dhe Miladi

Në qendër të rrefimit është Abed Salama, babai i Miladit 5-vjeçar, një prej fëmijëve që nuk do të kthehet më në shtëpi nga ai udhëtim. Thrall tregon historinë duke na kthyer vite pas, në shoqërinë palestineze, mes konventave dhe rivaliteteve familjare që do ta bëjnë atë të heqë dorë nga dashuria e parë dhe ta shtyjë të marrohet me një grua që nuk do, dhe më pas të kërkojë një grua të dytë në komunitetin e arabo-izraelitëve, për të marrë një dokument – Kartën Blu – që u lejoi atyre të lëvizin lirisht drejt Jeruzalemit. Së bashku me Abed Salama, ka shumë protagonistë të tjerë në libër: Huda Dabhour, një endokrinologe në UNRWA (agjencia e OKB-së për Palestinezët) e cila u rrit në mërgim pasi familja e saj u detyrua të largohej nga Haifa, në vitin 1948.


Ajo do të jetë e vetmja mjekja që do të ndërhyjë në terren, në një ditë që i kujton vitin 1985 kur, shumë e re, u thirr për të rikompozuar trupat e luftëtarëve palestinezë të vrarë në bombardimet izraelite ndaj selisë së OCL në Tunis.

Ose Dany Tirza, rezervist i ushtrisë izraelite, me nofken Abu Kharita, "babai i hartës", nga Yasser Arafat:

i ngarkuar me gjurmimin e rrugës së murit ndarës, ai që kishte filluar të punonte duke besuar tek paqja, dhe e gjeti veten duke planifikuar një pengesë që vërtetonte pamundësinë e saj. Ajo që e godet lexuesin është niveli në të cilin zgjedhjet politike që vijjnë nga larg përkshojnë çdo detaj të jetës së protagonistëve palestinezë, duke imponuar zgjedhje të tilla si ajo se ku t'i dërgojnë fëmijët në shkollë, ku të jetojnë, deri tek ajo më intime, mbi personin me të cilin do të marrohen.

"Unë besoj se ky libër është edhe më i dobishëm tani, në kontekstin e asaj që po shohim në Gaza," përfundon Thrall. "Zgjedhjet e bëra në këtë luftë nga pala izraelite janë përcaktuar të gjitha nga supozimi i dehumanizimit të tjetrit. Dhe nëse një pjesë e madhe e publikut këtu i mbështet, kjo është edhe sepse ata nuk e dinë se kush janë palestinezët, si jetojnë dhe çfarë ëndërojnë. Përpjekja për të folur për barbarizet themelore që përfetojnë ata që jetojnë nën pushtimin izraelit, si pamundësia për të shkuar për të kërkuar fëmijën tuaj në një shtet që është afër, por që nuk mundet sepse nëse nuk keni dokumentet e duhura, është edhe më shumë e rëndësishme tani". // Venerdi – Bota.al

EURO GLASS
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Hasan Hyseni, 'Ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 22 PRILL - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall vazhdojnë ndarjen e çmimit "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 30-të në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Prishtina,

Hasan Hyseni. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i veteranëve të futbollit në përbërje: Luzlim Berisha, Avni Shala dhe Adem Sylejmani. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i Javës" për xhiron e 30-të t'i takojë

Hasan Hysenit. Ky vendim u mor si rrjedhojë e peshës së ndeshjes Malisheva vs Prishtina. Pasi mori këtë çmim futbollisti i FC Prishtinës u shpreh i lumtur që u vlerësua si më i miri i javës. "Faleminderit për këtë çmim.

Është një vlerësim i madh për mua. Dua t'ia dedikoj të gjithë bashkëlojtarëve që kanë pasur meritë për këtë fitore. Shpresojmë që të vijë edhe çmime të tjera në të ardhmen", ka thënë Hasani për faqen zyrtare të FFK-së.



Ademi takohet me Sejдинin, pajtohen për bashkëpunim mes dy federatave

PRISHTINË, 22 PRILL - Federata e Futbollit të Kosovës dhe Federata e Futbollit të Maqedonisë së Veriut kanë shfaqur gatishmërinë e tyre për të avancuar bashkëpunimin e tyre. Kjo u konfirmua së fundmi në një takim miqësor midis presidentit të FFK-së, Agim Ademi dhe presidentit të FFM-së, Muamed Sejđini. Në këtë takim, presidenti Ademi e përgëzoi mikun e tij për arritjet e deritashme dhe Asamblesë e suksesshme të FFM-së në fundjavën që e lamë pas, e ku u konfirmua avancimi i futbollit të Maqedonisë së Veriut nën drejtimin e tij. "Dy presidentët diskutuan gjithashtu për potencialet e bashkëpunimit të mëtejshëm në mes të dy federatave, veçanërisht në zhvillimin e grupmoshave të reja

dhe në promovimin e futbollit për vajzat. Një prej ideve të diskutuara ishte organizimi i një kompeticioni të përbashkët për ekipet U13 dhe U14, duke përfshirë 3-4 ekipe nga secili kampionat. Sipas dy presidentëve, kjo garë do të ishte nxitje e konkurrencës së shëndetshme mes ekipeve të të rinjve dhe do të kontribuonte në rritjen e nivelit të futbollit dhe në zhvillimin e talenteve në të dyja vendet", thuhet në njoftimin e FFK-së. Temë tjetër që u trajtua në këtë takim ishte edhe çështja e sistemit VAR, të cilin tash e dy vjet FFK-ja është duke e zbatuar me sukses në kampionatin vendor. Presidenti Ademi shprehu gatishmërinë e FFK-së për të ndihmuar FFM-në në këtë proces me ekipet e tij të VAR-it.



Granit Rugova emërohet drejtor i Programeve dhe Projekteve Zhvillimore në FBK

PRISHTINË, 22 PRILL - Granit Rugova është emëruar drejtor i Programeve dhe Projekteve Zhvillimore në Federatën e Basketbollit të Kosovës. Bordi i kësaj federate e ka miratuar emërimin e tij pas propozimit nga Komisioni për

Intervista. "Rugova rikthehet në Federatën e Basketbollit të Kosovës pas dy vjetësh, ku ishte Drejtor i Përfaqësuesve të Kosovës", thuhet në komunikatën e FBK-së. "Graniti ka qenë basketbollist i Kosovës, si dhe basketbollist i Prishtinës, ku ka

fituar shumë trofe në karrierën e tij, derisa për një edicion ka mbrojtur ngjyrat e Bashkimit". Ai së fundi ka qenë Drejtor i Sportit në Komunën e Prishtinës. Kujtojmë se, Graniti ka përfunduar me sukses programin e FIBA-s, FIBA Time Out 2.0".


Juventusit në bisedime me Lille për Zhegrovën

TORINO, 22 PRILL - Gazetari italian Mirko Di Natale ka konfirmuar se Juventusit ka shprehur interesim për transferimin e sulmuesit kosovar Edon Zhegrova. "Bianconerët" janë duke kërkuar një vend në edicionin e ardhshëm të Ligës së Kampionëve, kështu që po synojnë që të përforcin ekipin në mënyrë që të konkurrojnë në

garën në prestigjioze për klube në Evropë. Kështu që sipas Di Natales, gjiganti italian është duke monitoruar nga afër situatën e Zhegrovës i cili po cilësohet si një kandidat i mundshëm për t'iu bashkuar klubit. Zhegrova u bë pjesë e Lille në janar të 2022, pasi kompletroi transferimin nga Baseli. Dy vite pas transferimit të tij, ai tani

llogaritet një ndër lojtarët kyç të ekipit francez. Këtë sezon, Zhegrova ka kontribuar me 11 gola të shënuar dhe nëntë asistime në të gjitha garat, duke bërë që të rrethëjë vëmendjen e disa klubeve të mëdha, përfshirë Juventusin. Gaztari gjithashtu ka zbuluar se 'Zonja e Vjetër' tashmë ka hapur bisedimet me rrethin e lojtarit, ndërsa duke

marrë parasysh se kontrata e tij me Lille është valide deri në 2026, shuma e kartonit të tij vlerësohet të jetë diku rreth 10-15 milionë euro. Sidoqoftë, për të siguruar shërbimet e tij, Juventusit duhet të mposht konkurrencën nga Napoli që gjithashtu thuhet se janë të interesuar për shërbimet e 25-vjeçarit.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Caffe Bar Arioni" SH.P.K. me seli në Gjiilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 812067173 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavaj se svi klienti da drustvo sa "Caffe Bar Arioni" D.O.O. Gjiilan, donelo odluku o prestani rada sa nr.b. 812067173 ujedno imenovao Likvidatora o sprovdjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Caffe Bar Arioni" L.L.C. with headquarters Gjiilan, has come to the decision to quit its business: 812067173 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpeite


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Bekim Veljiji shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.
- Nexhmedin Tulla shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Lavdije Sopi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Zef Lush Marku " Velezhe.
- Zylmi Krasniqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Edita Beqa nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Xhavit Januzi nga Nivokazi KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. Bujqësi " Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Fisnik Nixha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë, Elektroteknik.
- Kingj Nikolla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. " Kadri Kusari" Gjakovë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të në kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola CeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

